

VENDIM
Nr. 70, datë 22.8.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“KOMP.ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, 5 pika 1 germa “a”, 13 dhe 14 pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Komp.Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie me fuqi totale 4.21 MW,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Komp. Energji” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar pjesërisht. Është pa plotësuar germa “d”: Vërtetimi që drejtuesit nuk janë përfshirë në një proces penal, është jashtë afatit të përcaktuar në nenin 8, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar pjesërisht. Është pa plotësuar germa “a”: Vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave, është jashtë afatit të përcaktuar në nenin 8, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”).
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Komp. Energji” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Hurdhas 1” me fuqi të instaluar 1.71 MW, “Hurdhas 2” me fuqi të instaluar 1.3 MW dhe “Hurdhas 3” me fuqi të instaluar 1.2 MW (me fuqi totale 4.21 MW).

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti